

Vendim nr. 189 datë 15.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 15.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (P) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **POLO SINO**, përfaqësuar nga avokate Suela Hyseni, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 732, datë 16.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 478, datë 31.07.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-96, datë 21.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, i cili me vendimin nr. 2, datë 13.07.1997 të Këshillit të Bashkisë, Berat ka ndërruar emrin nga “Lavdosha” në “Polo”, ka nisur disa procese gjyqësore për caktimin atij, në vitin 1983, të pensionit si invalid. Duke pretenduar se në caktimin e këtij pensioni janë kryer falsifikime nga disa shtetas ose që ky pension nuk i është paguar për një periudhë të caktuar, ai ka paraqitur të paktën dy kallëzime penale, për të cilat në vijim janë zhvilluar paralelisht dy procese gjyqësore.

Procesi gjyqësor i përfunduar më parë në kohë

2. Në datën 23.04.2019 kërkuesi ka paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (*Prokuroria Elbasan*) kallëzim penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (*KP*) ndaj disa shtetasve. Sipas kallëzimit, këta persona kishin falsifikuar dokumente që kishin të bënin me faktin e paraqitjes së tij në komisione mjeko-ligjore dhe lëshimin nga ato të tre raporteve mjekësore respektivisht në datat 06.01.1982 dhe 08.01.1982, kur ai ka qenë oficer aktiv në Forcat e Armatosura, si dhe në datën 18.01.1984, pasi ishte liruar nga kjo detyrë (më 15.02.1982), pa pasur ai dijeni, pa paraqitur kërkesë dhe pa marrë pjesë në ato komisione, raporte mjeko-ligjore për të cilat në vijim ka dalë edhe vendimi për pensionin e invaliditetit. Falsifikimet, sipas kërkuesit, ishin kryer nga shtetas I.V. (burri i motrës së tij), në bashkëpunim me ish-bashkëshorten e tij S.R. dhe shtetasin R.R., ndërsa dokumentet e falsifikuara ishin zbuluar nga ai gjatë viteve 2015-2016, pasi në atë kohë i janë vënë në dispozicion. Pas shqyrtimit të kallëzimit, Prokuroria Elbasan, me vendimin e datës 07.05.2019, bazuar në nenet 290, pika “1”, shkronja “e” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se dokumentet e pretenduara si të falsifikuara datojnë në vitet 1983 - 1990, ndaj edhe nëse ato do të ishin të falsifikuara, ndjekja penale nuk mund të fillonte, sepse vepra penale e kallëzuar ishte parashikuar për shkak të kalimit të afateve të përcaktuara në nenin 66 të KP-së.

3. Kërkuesi e ka kundërshtuar në gjykatë vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Me vendimin nr. 793, datë 20.01.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore, duke e gjetur të drejtë qëndrimin e prokurorit se referuar nenit 66 të KP-së ndjekja penale nuk mund të fillonte. Ky vendim në vijim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2020-648 (108), datë 27.05.2020, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1898, datë 21.11.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

Procesi i dytë gjyqësor

4. Në datën 25.09.2018 kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (*Prokuroria Vlorë*) për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së, duke pretenduar se dokumentet që kanë shërbyer për akordimin atij të pensionit të invaliditetit kanë qenë të falsifikuara, pasi raporti mjekësor i vitit 1982 është improvizuar; gjetjet e raportit të dytë mjekësor të datës 06.01.1982 se sëmundja i ka filluar përpara hyrjes në ushtri nuk janë të vërteta; në datën 18.01.1984 është kryer një tjetër falsifikim për sëmundjen e tij, ndërsa në datën 10.05.1984 shtetasi I.V. ka marrë një deklaratë nga kryetari i këshillit të fshatit Vranisht, shtetasi Sh.P., sikur ai (kërkuesi) ishte me të meta mendore. Ky shtetas, sipas kërkuesit, në një proces gjyqësor të vënë në lëvizje me një padi të tij në vitin 1996, gjatë pyetjes si dëshmitar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, ka dëshmuar se atë deklaratë e ka bërë i shtyrë nga njerëzit e ish-bashkëshortes së tij. Po sipas kallëzimit, falsifikimet ishin kryer nga ish-bashkëshortja S.R., ish-baxhanaku i tij S.Ç., në bashkëpunim edhe me shtetasin R.A., ndërsa paratë e pensionit deri në vitin 1990 nuk i ishin paguar dhe se në vitin 1984 ato janë tërhequr nga ish-bashkëshortja. Mbi bazën e këtij kallëzimi është regjistruar procedimi penal nr. 2266 i vitit 2018 (*procedimi penal nr. 2266/2018*), për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së.

5. Gjatë hetimit paraprak të këtij procedimi penal, nga të dhënat e administruara nga Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Berat, ka rezultuar se kërkuesi është trajtuar me pension invaliditeti për periudhën 15.03.1983 - 31.01.1986, me numër dosjeje 2662/2, dosje që më pas, në datën 24.10.1986, i është transferuar DRSSH-së, Vlorë. Për këtë periudhë pensioni i invaliditetit nuk është tërhequr nga Arka Qendrore e Kursimit Berat, ndërsa për të njëjtën periudhë bashkëshortja e kërkuesit ka përfitur pensionin ushqimor. Aktualisht kërkuesi përfiton pensionin pranë DRSSH-së, Gjirokastrë, ku, sipas të dhënave të administruara nga kjo e fundit, ky pension është caktuar me vendimin nr. 25, datë 30.04.1987, si invalidi i grupit të dytë dhe se pagesa e pensionit është kryer deri në datën 31.01.2019 në Intesa Sanpaolo Bank, sipas kërkesës së kërkuesit. Në përfundim të hetimeve Prokuroria Vlorë ka paraqitur kërkesë për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se nga provat e grumbulluara nuk provohen elementet e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

6. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 732, datë 16.05.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e procedimit penal nr. 2266/2018, për shkak se fakti nuk parashikohej si vepër penale. Sipas gjykatës, gjatë gjykimit ka rezultuar e provuar se në trajtimin me pension të kërkuesit nuk ishin falsifikuar dokumente dhe ai vazhonte të trajtohej

me pension nga DRSSH-ja, Gjirokastrë, pagesat për të cilin ishin kryer në Intesa Sanpaolo Bank, sipas kërkesës së kërkuarit, dhe ishin tërhequr po prej tij. Për sa u përket pretendimeve për llogaritë bankare me Raiffeisen Bank, gjykata ka vënë në dukje se në to nuk ishin kryer veprime që në kohën e transferimit të tyre në bankë dhe pagesat vazhdonin të ishin në gjendje të palëvizshme, përveç veprimeve të kryera në mënyrë automatike nga sistemi për kreditimin e llogarisë me shumën e interesit, debitimit të saj për mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat ose mbajtjen e komisioneve. Sipas bankës, llogaritë në fjalë i përkisnin kërkuarit, por se ai nuk kishte pranuar të kryente veprime me pretendimin se nuk kishte çelur numra llogarie në ish-Bankën e Kursimeve. Sipas gjykatës, në kushtet kur fakti i kallëzuar nuk parashikohej nga ligji si vepër penale procedimit penal duhej pushuar. Kundër këtij vendimi kërkuar ka ushtruar ankim, duke pretenduar se hetimet nuk kanë qenë të plota.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 478, datë 31.07.2019, në dhomën e këshillimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Edhe sipas gjykatës së apelit, prokuroria ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për përcaktimin nëse fakti i referuar përbënte ose jo vepër penale dhe konkluzioni i arritur nga ajo ishte i drejtë. Nga ana tjetër, veprimet hetimore të kërkuara nga kërkuar nuk janë të domosdoshme për të hedhur dritë mbi faktin e pretenduar se në dosjen e invaliditetit nr. 2662/2 ndodhen dokumente të falsifikuara, konkretisht raporte mjeko-ligjore që datojnë deri në vitin 1990. Sipas saj, kallëzimi i shtetasit duhet të përmbajë jo vetëm pretendimin se është kryer një vepër penale, por edhe të dhëna të besueshme se ajo është kryer, çka nuk rezulton në rastin konkret. Përkundrazi, nga hetimi ka rezultuar se pensioni i invaliditetit të kallëzuesit është i depozituar në Raiffeisen Bank, së cilës i kanë kaluar llogaritë e ish-Bankës së Kursimeve pas blerjes së saj, ndërsa llogaria e kallëzuesit është hapur si llogari pensioni invaliditeti. Po kështu, ish-bashkëshortja e tij ka përfituar vetëm detyrimin për ushqim deri më 31.10.1986, ndërsa diferenca e pensionit të invaliditetit ka mbetur gjendje në llogari. Në mungesë të ndonjë të dhëne mbështetëse, vetëm deklaratimet e kallëzuesit janë të pamjaftueshme për të hetuar për vërtetësinë e raporteve mjeko-ligjore. Ndryshe nga sa ai pretendon, administrimi i dosjes së pensionit të invaliditetit dhe i dosjes përmbartimore të vitit 1986 ose edhe marrja e deklaratimeve nga shtetasit e kallëzuar, nuk mund të sjellin të dhëna për vërtetësinë e akteve mjeko-ligjore në kohën e lëshimit të tyre. Për më tepër kur edhe sipas pretendimeve të tij, në të gjitha ato akte është arritur në të njëjtin konkluzion, i cili nuk duket se bie ndesh me ndonjë provë shkresore, përveçse duke pasur parasysh edhe llojin e pensionit që kallëzuesi merr aktualisht. Kundër këtij vendimi kërkuar ka ushtruar rekurs, duke parashtruar, në thelb, të njëjtat argumente me ato të parashtruara në ankim.

8. Me vendimin nr. 00-2025-96, datë 21.01.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

9. Në datën 20.05.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual kundër procesit të dytë gjyqësor, ankim i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuarit

10. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes të lidhur me parimin e barazisë së armëve*, pasi prokuroria dhe gjykatat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të verifikuar veprimet ose mosveprimet e kryera nga personat e kallëzuar prej tij. Në aktin e lirimit të tij nga detyra e oficerit të vitit 1982 nuk është përcaktuar që lirimi të jetë bërë për shkaqe shëndetësore. Po kështu, raporti i parë mjeko-ligjor është përpiluar nga mjekë kardiologë, patologë e reumatologë, pa kompetencë në përpilimin e tyre, ndërsa raporti tjetër në vijim po i vitit 1982 nuk mban shënimin e mjekut që e ka hartuar. Edhe sipas vërtetimit nr. 1219, datë 22.06.1984 të Komandës së Repartit Ushtarak Delvinë, prej muajit shtator 1980 e deri më 01.03.1982 të shërbimit në atë repart ai nuk ka dalë në komisionin mjeko-ligjor. Hetimet nuk kanë qenë të plota e të gjithanshme, ndaj gjykatat nuk mund të konkludonin se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Nuk është hetuar se nga kush është hapur dosja e pensionit të invaliditeti, dokumentet e përdorura për hapjen e saj dhe nëse ajo është aktive, nuk është marrë informacion i detajuar nga zyrat e përmbarimit Berat e Vlorë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për pensionin ushqimor, nuk është përcaktuar nëse llogaria në Raiffeisen Bank i përket atij dhe çfarë dokumentesh janë përdorur për hapjen e saj.

10.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur në raste të ngjashme, pavarësisht provave të paraqitura prej tij.

10.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar vendimet e tyre, por janë mjaftuar me citimin e neneve të KPP-së. Gjykata e apelit është shprehur, nga njëra anë, se bazuar në nenet 149 e 150

të KPP-së, objekt i të provuarit në procesin penal janë faktet dhe rrethanat që lidhen me veprat penale e që shërbejnë për kryerjen ose jo të veprës e pasojat e ardhura, ndërsa nga ana tjetër se kallëzimi penal duhet të përmbajë jo vetëm pretendimin për kryerjen e një vepre penale, por edhe të dhëna të besueshme për kryerjen e saj. Kjo gjykatë ka arritur në përfundimin se prokuroria ka kryer të gjitha veprimet hetimore për të përcaktuar nëse fakti përbën vepër penale, pa treguar veprimet hetimore të kryera. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs, por është mjaftuar vetëm me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga ligji.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur për pushimin e procedimit penal të regjistruar për kallëzimin penal të paraqitur nga ai. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale kërkuuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

13. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është

viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur pushimi i procedimit penal, duke kundërshtuar, në thelb, mosndjekjen penale të personave të kallëzuar prej tij se kanë falsifikuar dokumente që datojnë në vitet 1982 - 1990, mbi bazën e të cilave atij i është dhënë pensioni i invaliditetit. Kërkuesi nuk ka pretendime për akordimin e këtij pensioni, por vetëm për sa i përket shkakut të tij, duke kundërshtuar, në thelb, sëmundjen e pasqyruar në aktet mjekësore të kohës, gjë që sipas tij përbën edhe veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Në lidhje me këtë gjykatat e zakonshme kanë arritur në përfundimin se nuk ka asnjë të dhënë nga ndonjë provë shkresore që mund të vinte në dyshim vërtetësinë e akteve mjekësore në kohën e lëshimit të tyre, pra më shumë se 28 vjet përpara paraqitjes së kallëzimit nga ana e kërkuesit. Po për të njëjtin pretendim të kërkuesit, në procesin tjetër gjyqësor të vënë në lëvizje me ankimin e tij ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal (procesi i parë), prokurori dhe gjykatat e zakonshme në vijim kanë arritur në përfundimin se edhe nëse ato dokumente mjekësore do të ishin të falsifikuara, ndjekja penale nuk mund të fillonte për shkak të parashkrimit të veprës penale. Po kështu, kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për faktin e mospagimit të pensionit të invaliditetit për periudhën 1983 - 1990 dhe për tërheqjen e tij në vitin 1986 nga ish-bashkëshortja, gjë për të cilën prokuroria dhe në vijim edhe gjykatat e zakonshme në procesin gjyqësor të kundërshtuar kanë arritur në përfundimin se shuma e pensionit për atë periudhë është paguar duke iu kaluar kërkuesit në një llogari bankare, ku është gjendje edhe sot, ndërkohë që ish-bashkëshortja e tij në periudhën përkatëse ka tërhequr vetëm detyrimin për ushqim.

15. Për sa më lart, Kolegji vëren se ndonëse në themel pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me të dhënat personale (në thelb me ndreqjen ose fshirjen e sëmundjes së pasqyruar në aktet mjekësore të kohës) dhe të drejtën për sigurime shoqërore (pagimin e pensionit të invaliditetit), ato nuk lidhen drejtpërdrejt me procesin penal të vënë në lëvizje nëpërmjet kallëzimit kundër disa shtetasve. Në rrethanat e rastit konkret, procesi penal duket se nuk mund të sjellë pasojat materiale që kërkuesi synon, përveçse ai as nuk e kushtëzon atë në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale (civile) që ai pretendon se i janë shkelur. Nga ana tjetër, Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk garantojnë të drejtën për të filluar

ndjekje penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.09.2006*).

16. Bazuar në këto konsiderata, Kolegji vlerëson se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuarit në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.